



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.3355/5 prot.

Datë 15.12.2025

V E N D I M
Nr. 1851/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 15.12.2025 u shqyrtua ankesa me

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “DataLog” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me nr. REF-65750-10-20-2025, me objekt: “Mirëmbajtja për Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore”, me fond limit 4.989.800 lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 07.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Durrës, me adresë: Sheshi “Liria”, Durrës

Ankimues: Operatori ekonomik “DataLog” SHPK me NUIS L32402003S dhe adresë: Njesia Bashkiake nr. 5, Rr. Deshmoret e Kombit, Kulla 2, kati 4, Tiranë.

Baza Ligjore: Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”,

dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 21.10.2024, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit *E hapur e thjeshtuar*, me nr. REF-65750-10-20-2025, me objekt: “Mirëmbajtja për Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore”, me fond limit 4.989.800 lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 07.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

II.2. Në datën 13.11.2025 autoriteti kontraktor ka përfunduar fazën e vlerësimit të ofertave. Ofertuesit janë njoftuar elektronikisht si vijon:

1. “Data Log” SHPK 4.788.000 lekë, skualifikuar

Operatori ekonomik “Data Log” SHPK është njoftuar elektronikisht për arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

“Për ofertuesin DATA LOG shpk me nipt L32402003S, me vlerë të ofertës 4’788’000 lekë, Komisioni i Vleresimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit dhe vleresimit të dokumentacionit, konstatoi se, ofertuesi DATA LOG shpk nuk përmbush shtojcën 9 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pikën 2.3.2 të ndryshuar me shtojcën e datës 28.10.2025, përcakton se:

Pika 2.3.2 Bëhet: (Shtohet argumentimi)

Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

a. Punonjës për sistemin e operimit Oracle Linux ose ekuivalent 2(dy)

Te pakten 2 (dy) punonjës me certifikim për sistemin e operimit Oracle Linux (ose ekuivalent) në cilin është instaluar sistemi i menaxhimit financiar. Te deshmohen me certifikatat perkatese.

b. Punonjës për implementimin e bazave të të dhënave Oracle ose ekuivalent 2(dy)

Te pakten 2 (dy) punonjës me certifikim për implementimin e bazave të të dhënave Oracle (ose ekuivalent). Te deshmohen me certifikatat perkatese.

c. Punonjës për administrimin e bazave të të dhënave Oracle ose ekuivalent 2(dy)

Te pakten 2 (dy) punonjës me certifikim për administrimin e bazave të të dhënave Oracle (ose ekuivalent). Te deshmohen me certifikatat perkatese.

d. Punonjës për zhvillim software-i në Oracle PL/SQL ose ekuivalent 2(dy)

Te pakten 2 (dy) punonjës me certifikim për zhvillim software-i në Oracle PL/SQL (ose ekuivalent). Te deshmohen me certifikatat perkatese.

e. Punonjës për zhvillim software-i në Oracle Forms ose ekuivalent 2(dy)

Te pakten 2 (dy) punonjës të certifikuar për zhvillim software-i në Oracle Forms (ose ekuivalent). Te deshmohen me certifikatat perkatese.

f. Punonjës për (General Ledger), (Payables), (Receivables) ose ekuivalent 2 (dy)

Te pakten 2 (dy) punonjës të certifikuar nga Oracle për implementimin e modulit të Librit të Madh (General Ledger) ose ekuivalent, të Pagueshmeve (Payables) ose ekuivalent, të Arketueshmeve (Receivables) ose ekuivalent. Te deshmohen me certifikatat perkatese.

g. Punonjës për të certifikuar për virtualizim ose ekuivalent 2 (dy)

Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar për virtualizim ose ekuivalent;

h. Punonjës të të certifikuar si menaxher projekti ose ekuivalente 1 (një)

Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si menaxher projekti ose ekuivalente.

i. Punonjës të certifikuar për menaxhimin e shërbimeve IT (ITIL ose ekuivalente) 1 (një)

Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhimin e shërbimeve IT (ITIL ose ekuivalente).

Arsyetim teknik për kërkesën e punonjësve të certifikuar:

Në hartimin e pikës 2.3.2 “Kapaciteti teknik dhe profesional” është parashikuar që operatori ekonomik pjesëmarrës të disponojë në total 16 punonjës të certifikuar, të ndarë sipas fushave specifike të shërbimeve Oracle dhe teknologjive mbështetëse. Ky kriter është vendosur jo për të kufizuar konkurrencën, por për të garantuar cilësinë, qëndrueshmërinë dhe sigurinë e zbatimit të projektit gjatë gjithë ciklit të jetës së kontratës.

1. Sigurimi i vazhdimësisë së shërbimit

Objekti i kontratës përfshin shërbime të ndërlukuara që lidhen me:

- Sisteme operative Oracle Linux (ose ekuivalente);
- Baza të të dhënave Oracle;
- Zhvillime software në PL/SQL dhe Oracle Forms;
- Implementim të moduleve financiare si General Ledger, Payables, Receivables;
- Virtualizim dhe administrim IT.

Për këtë arsye, u vlerësua se për çdo kategori të shërbimit duhet të ketë minimalisht dy persona të certifikuar:

- në mënyrë që të sigurohet zëvendësueshmëri në rast sëmundjeje, leje, dorëheqje apo ngarkese të lartë pune;
- për të shmangur varësinë nga një individ i vetëm në një fushë kritike për funksionimin e sistemit financiar.

Kjo politikë ndjek parimin back-up njerezor, e cila është praktikë standarde në projektet e teknologjisë së informacionit që kanë ndikim direkt në procese financiare dhe institucionale.

2. Siguri në ruajtjen e njohurive institucionale.

Projekti ka në thelb sisteme Oracle që kërkojnë njohuri shumë të specializuara dhe të fituara përmes certifikimeve ndërkombëtare. Nëse operatori ekonomik do të kishte vetëm një punonjës të certifikuar për secilën fushë, ekziston rreziku që, në rast largimi apo mungese të tij, njohuritë kritike humbasin dhe projekti mbetet i bllokuar.

Prandaj kërkesa për dy persona të certifikuar për çdo fushë siguron që njohuritë dhe përgjegjësitë të ndahen, të dokumentohen dhe të jenë gjithmonë të transferueshme brenda ekipit.

3. Nevoja për punë paralele dhe faza kritike

Në fazat e implementimit dhe mirëmbajtjes, shpesh është e nevojshme që disa detyra të kryhen njëkohësisht, si:

- konfigurimi i serverëve dhe testimi i bazës së të dhënave;
- zhvillimi i moduleve PL/SQL ndërkohë që bëhen rregullime në Oracle Forms;
- implementimi i moduleve financiare në disa njësi njëkohësisht.

Në këto raste, vetëm një person i certifikuar për çdo fushë do të krijonte vonesa, ngarkesë të tepërt dhe rrezik operativ. Dy persona për çdo fushë lejojnë ndarjen e punës dhe garantojnë përfundimin në afatet kontraktuale.

4. Rrjedhijat në mungesë të stafit të dyfishtë

Nëse projekti do të mbështetej vetëm te një individ për secilën teknologji, çdo mungesë apo problem personal i tij do të shkaktonte:

- ndërprerje të menjëhershme të shërbimit teknik;
- pamundësi për të reaguar në kohë ndaj incidenteve;
- vonesa në zbatim dhe rrezik penaltetesh për operatorin dhe autoritetin kontraktor.

Duke kërkuar minimalisht dy persona të kualifikuar për çdo komponent, sigurohet vazhdimësi e shërbimit 24/7 dhe reduktim i riskut operacional.

5. Përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare

Ky parim i “dyfishimit të kapaciteteve kritike” është praktikë e zakonshme në projektet e sistemit Oracle, dhe rekomandohet nga:

- Oracle Implementation Best Practices (për të patur backup technical resources);
- Standardet ISO/IEC 20000-1 për menaxhimin e shërbimeve IT, ku kërkohet resilience dhe risk mitigation në burimet njerëzore.

6. Përfundim

Në përfundim, kërkesa për punonjës të certifikuar:

- është në përpjesëtim me kompleksitetin dhe rëndësinë e objektit të kontratës;
- nuk synon të kufizojë pjesëmarrjen, por të garantojë cilësi, siguri dhe vazhdimësi shërbimi;
- siguron që operatori ekonomik të ketë kapacitet real për përballimin e çdo situatë, edhe në rast mungesash apo ngarkesash të papritura.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtyre kriterëve me siper, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin: Certifikimet që vërtetojnë kualifikimin e personelit si dhe të provojë disponueshmërinë e personelit të vërtetuar kjo me formularët E-sig te listëpagesave aktuale të konfirmuara pranë autoriteteve tatimore.

Kriteret më lartë (nga 2.3.2 a-i), quhen të përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST.

Komisioni i Vlerësimit të ofertave, përpara hapjes së ofertave i ka kërkuar grupit të specifikimeve teknike që të marrë masa për modifikimin e kriterit të kapaciteti teknik dhe profesional, në pikën 2.3.2 (punonjës të specializuar/të kualifikuar) në mënyrë të tillë që të mos kufizojë konkurrencën, pasi përcaktimin/apo vendosjen e kriterëve specifikë, në thelb janë kriterë fituese, Referuar kriterit të kërkuar dhe të argumentuar nga specialistët e fushës (grupi i specifikimeve teknike) është përcaktuar shprehimisht si më poshtë:

- çdo kategori të shërbimit duhet të ketë minimalisht dy persona të certifikuar:
- të sigurohet zëvendësueshmëri në rast sëmundjeje, leje, dorëheqje apo ngarkese të lartë pune për të shmangur varësinë nga një individ i vetëm në një fushë kritike për funksionimin e sistemit financiar
- Nëse operatori ekonomik do të kishte vetëm një punonjës të certifikuar për secilën fushë, ekziston rreziku që, në rast largimi apo mungese të tij, njohuritë kritike humbasin dhe projekti mbetet i bllokuar
- dy persona të certifikuar për çdo fushë siguron që njohuritë dhe përgjegjësitë të ndahen, të dokumentohen dhe të jenë gjithmonë të transferueshme brenda ekipit
- Në fazat e implementimit dhe mirëmbajtjes, shpesh është e nevojshme që disa detyra të kryhen njëkohësisht
- Duke kërkuar minimalisht dy persona të kualifikuar për çdo komponent, sigurohet vazhdimësi e shërbimit 24/7 dhe reduktim i riskut operacional,

Sa më sipër rezulton se ofertuesi nuk plotëson shërbimet për këto kategori të specializuara:

1. Për pikën c. Punonjës për administrimin e bazave të të dhënave Oracle ose ekuivalent, Ofertuesit i mungon 1(një) punonjës me certifikim për administrimin e bazave të të dhënave Oracle, pasi punonjësi D.M është kualifikuar/mbulon pikën « b ».

2. Për pikën h. Punonjës të të certifikuar si menaxher projekti ose ekuivalente, Ofertuesit i mungon 1(një) punonjës i certifikuar si menaxher projekti ose ekuivalente, pasi punonjësi D.M është kualifikuar/mbulon pikën « b. » dhe punonjësi E.D është kualifikuar/mbulon pikën « c ».

3. Për pikën i. Punonjës të certifikuar për menaxhimin e shërbimeve IT (ITIL ose ekuivalente), Ofertuesit i mungon 1(një) punonjës i certifikuar për menaxhimin e shërbimeve IT (ITIL ose ekuivalente), pasi punonjësi E.D është kualifikuar/mbulon pikën « c » dhe punonjësi D.M është kualifikuar/mbulon pikën « b ».

Përsa më lart, ofertuesi nuk e përmbush piken 2.3.2 të kërkesave të tjera të veçanta për kualifikim. Anëtarët e KVO vendosin që ofertuesi DATA LOG shpk të mos kualifikohet. ”

II.3. Në datën 14.11.2025 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e anulimit të procedurës së prokurimit në SPE.

II.4. Në datën 20.11.2025, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik, me nr. A/2025/6104, protokolluar me nr.3355/2025 prot, datë 20.11.2025, i operatorit ekonomik “DataLog” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me nr. REF-65750-10-20-2025, me objekt: “Mirëmbajtja për Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore”, me fond limit 4.989.800 lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 07.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “DataLog” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Konkretisht pretendohet si vijon:

“Sipas vleresimit ne SPE te dates 13.11.2025, KVO ka skualifikuar oferten tone me argumentimin se: “ofertuesi nuk ploteson sherbimet per keto kategori te specializuara:

1. Per piken c Punonjes per Administrimin e bazave te te dhenave Oracle ose ekuivalent, Ofertuesit i mungon 1(nje) punonjes Me certifikim per administrimin e bazave te te dhenave Oracle, pasi punonjesi D.M eshte kualifikuar/mbulon piken “b”.

2. Per piken h. Punonjes te certifikuar si menaxher projekti ose ekuivalente, Ofertuesit i mungon 1(nje) punonjes i certifikuar si menaxher projekti ose ekuivalente, pasi punonjesi D.M eshte kualifikuar/mbulon piken “b” dhe punonjesi E.D eshte kualifikuar/mbulon piken “c”.

3. Per piken i. Punonjes te certifikuar per menaxhimin e sherbimeve IT (ITIL ose ekuivalente), Ofertuesit i mungon 1(nje) punonjes i certifikuar per menaxhimin e sherbimeve IT (ITIL ose ekuivalente), pasi punonjesi E.D eshte kualifikuar/mbulon piken “c” dhe punonjesi D.M eshte kualifikuar/mbulon piken “b”.

Persa me lart, ofertuesi nuk permbush piken 2.3.2 te kerkesave te tjera te vecanta per kualifikim. Anetaret e KVO vendosin qe ofertuesi DATA LOG shpk te mos kualifikohet?."

ANKESA 1

Ne DST dhe shtojcen e publikuar nga AK ne daten 29.10.2025, percaktohet ndryshimi i kriterit te kualifikimit 2.3.2 si me poshte vijon:

!...

Pika 2.3.3

Ishte:

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë personel prej minimalisht 12 persona. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Bëhet: (veç ndryshimit, shtohet argumentimi si mëposhtë)

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë personel prej minimalisht 16 persona. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Kjo kërkesë është parashikuar që operatori ekonomik pjesëmarrës të disponojë në total 16 punonjës të certifikuar, të ndarë sipas fushave specifike të shërbimeve Oracle dhe teknologjive mbështetëse. Ky kriter është vendosur jo për të kufizuar konkurrencën, por për të garantuar cilësinë, qëndrueshmërinë dhe sigurinë e zbatimit të projektit gjatë gjithë ciklit të jetës së kontratës.

Pika 2.3.2

Ishte:

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

a. Punonjës për sistemin e operimit Oracle Linux ose ekuivalent 2(dy)

Te pakten 2 (dy) punonjës me certifikim për sistemin e operimit Oracle Linux (ose ekuivalent) në të cilin është instaluar sistemi i menaxhimit financiar. Te deshmohen me certifikatat perkatese.

b. Punonjës për implementimin e bazave të të dhënave Oracle ose ekuivalent 2(dy)

Te pakten 2 (dy) punonjës me certifikim për implementimin e bazave të të dhënave Oracle (ose ekuivalent). Te deshmohen me certifikatat perkatese.

c. Punonjës për administrimin e bazave të të dhënave Oracle ose ekuivalent 2(dy)

Te pakten 2 (dy) punonjës me certifikim për administrimin e bazave të të dhënave Oracle (ose ekuivalent). Te deshmohen me certifikatat perkatese.

d. Punonjës për zhvillim software-i në Oracle PL/SQL ose ekuivalent 2(dy)

Te pakten 2 (dy) punonjës me certifikim për zhvillim software-i në Oracle PL/SQL (ose ekuivalent). Te deshmohen me certifikatat perkatese.

e. Punonjës për zhvillim software-i në Oracle Forms ose ekuivalent 2(dy)

Te pakten 2 (dy) punonjës të certifikuar për zhvillim software-i në Oracle Forms (ose ekuivalent). Te deshmohen me certifikatat perkatese.

f. Punonjës për (General Ledger), (Payables), (Receivables) ose ekuivalent 2 (dy)

Te pakten 2 (dy) punonjës të certifikuar nga Oracle për implementimin e modulit e Librit të Madh (General Ledger) ose ekuivalent, të Pagueshmeve (Payables) ose ekuivalent, të Arketueshmeve (Receivables) ose ekuivalent. Te deshmohen me certifikatat perkatese.

g. Punonjës për të certifikuar për virtualizim ose ekuivalent 2 (dy)

Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar për virtualizim ose ekuivalent;

h. Punonjës të të certifikuar si menaxher projekti ose ekuivalente 1 (një)

Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si menaxher projekti ose ekuivalente.

i. Punonjës të certifikuar për menaxhimin e shërbimeve IT (ITIL ose ekuivalente) 1 (një)

Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhimin e shërbimeve IT (ITIL ose ekuivalente).

Për të dëshmuar përmbushjen e këtyre kriterëve me sipër, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

Certifikimet qe vertetojne kualifikimin e personelit.

Personeli i mësipërm duhet të ketë aktualisht një marrëdhënie pune me ofertuesin jo me pak se 1 (nje) muaj, e vërtetuar kjo me formularet E-sig te listëpagesave të konfirmuara pranë autoriteteve tatimore.

Kriteret më lartë (nga 2.3.2 a-i), quhen të përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Bëhet: (Shtohet argumentimi)

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

j. Punonjës për sistemin e operimit Oracle Linux ose ekuivalent 2(dy)

Te pakten 2 (dy) punonjës me certifikim per sistemin e operimit Oracle Linux (ose ekuivalent) ne te cilin eshte i instaluar sistemi i menaxhimit financiar. Te deshmothen me certifikatat perkatese.

k. Punonjës për implementimin e bazave të të dhënave Oracle ose ekuivalent 2(dy)

Te pakten 2 (dy) punonjës me certifikim per implementimin e bazave të të dhënave Oracle (ose ekuivalent). Te deshmothen me certifikatat perkatese.

l. Punonjës për administrimin e bazave të të dhënave Oracle ose ekuivalent 2(dy)

Te pakten 2 (dy) punonjës me certifikim per administrimin e bazave të të dhënave Oracle (ose ekuivalent). Te deshmothen me certifikatat perkatese.

m. Punonjës për zhvillim software-i ne Oracle PL/SQL ose ekuivalent 2(dy)

Te pakten 2 (dy) punonjës me certifikim per zhvillim software-i ne Oracle PL/SQL (ose ekuivalent). Te deshmothen me certifikatat perkatese.

n. Punonjës për zhvillim software-i ne Oracle Forms ose ekuivalent 2(dy)

Te pakten 2 (dy) punonjës te certifikuar per zhvillim software-i ne Oracle Forms (ose ekuivalent). Te deshmothen me certifikatat perkatese.

o. Punonjës për (General Ledger), (Payables), (Receivables) ose ekuivalent 2 (dy)

Te pakten 2 (dy) punonjës te certifikuar nga Oracle per implementimin e modulit e Librit te Madh (General Ledger) ose ekuivalent, te Pagueshmeve (Payables) ose ekivalent, te Arketueshmeve (Receivables) ose ekuivalent. Te deshmothen me certifikatat perkatese.

p. Punonjës për të certifikuar për virtualizim ose ekuivalent 2 (dy)

Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar për virtualizim ose ekuivalent;

q. Punonjës të të certifikuar si menaxher projekti ose ekuivalente 1 (nje)

Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si menaxher projekti ose ekuivalente.

r. Punonjës të certifikuar për menaxhimin e shërbimeve IT (ITIL ose ekuivalente) 1 (nje)

Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhimin e shërbimeve IT (ITIL ose ekuivalente).

Arsyetim teknik për kërkesën e punonjësve të certifikuar:

Në hartimin e pikës 2.3.2 “Kapaciteti teknik dhe profesional” është parashikuar që operatori ekonomik pjesëmarrës të disponojë në total 16 punonjës të certifikuar, të ndarë sipas fushave specifike të shërbimeve Oracle dhe teknologjive mbështetëse. Ky kriter është vendosur jo për të kufizuar konkurrencën, por për të garantuar cilësinë, qëndrueshmërinë dhe sigurinë e zbatimit të projektit gjatë gjithë ciklit të jetës së kontratës.

1. Sigurimi i vazhdimësisë së shërbimit

Objekti i kontratës përfshin shërbime të ndërlikuara që lidhen me:

- Sisteme operative Oracle Linux (ose ekuivalente);
- Baza të të dhënave Oracle;
- Zhvillime software në PL/SQL dhe Oracle Forms;
- Implementim të moduleve financiare si General Ledger, Payables, Receivables;
- Virtualizim dhe administrim IT.

Për këtë arsye, u vlerësua se për çdo kategori të shërbimit duhet të ketë minimalisht dy persona të certifikuar:

- në mënyrë që të sigurohet zëvendësueshmëri në rast sëmundjeje, leje, dorëheqje apo ngarkese të lartë pune;
- për të shmangur varësinë nga një individ i vetëm në një fushë kritike për funksionimin e sistemit financiar.

Kjo politikë ndjek parimin back-up njerezor, e cila është praktikë standarde në projektet e teknologjisë së informacionit që kanë ndikim direkt në procese financiare dhe institucionale.

2. Siguri në ruajtjen e njohurive institucionale.

Projekti ka në thelb sisteme Oracle që kërkojnë njohuri shumë të specializuara dhe të fituara përmes certifikimeve ndërkombëtare. Nëse operatori ekonomik do të kishte vetëm një punonjës të certifikuar për secilën fushë, ekziston rreziku që, në rast largimi apo mungese të tij, njohuritë kritike humbasin dhe projekti mbetet i bllokuar.

Prandaj kërkesa për dy persona të certifikuar për çdo fushë siguron që njohuritë dhe përgjegjësitë të ndahen, të dokumentohen dhe të jenë gjithmonë të transferueshme brenda ekipit.

3. Nevoja për punë paralele dhe faza kritike

Në fazat e implementimit dhe mirëmbajtjes, shpesh është e nevojshme që disa detyra të kryhen njëkohësisht, si:

- konfigurimi i serverëve dhe testimi i bazës së të dhënave;*
- zhvillimi i moduleve PL/SQL ndërkohë që bëhen rregullime në Oracle Forms;*
- implementimi i moduleve financiare në disa njësi njëkohësisht.*

Në këto raste, vetëm një person i certifikuar për çdo fushë do të krijonte vonesa, ngarkesë të tepërt dhe rrezik operativ. Dy persona për çdo fushë lejojnë ndarjen e punës dhe garantojnë përfundimin në afatet kontraktuale.

4. Rrjedhojat në mungesë të stafit të dyfishtë

Nëse projekti do të mbështetej vetëm te një individ për secilën teknologji, çdo mungesë apo problem personal i tij do të shkaktonte:

- ndërprerje të menjëhershme të shërbimit teknik;*
- pamundësi për të reaguar në kohë ndaj incidenteve;*
- vonesa në zbatim dhe rrezik penaltitësh për operatorin dhe autoritetin kontraktor.*

Duke kërkuar minimalisht dy persona të kualifikuar për çdo komponent, sigurohet vazhdimësi e shërbimit 24/7 dhe reduktim i riskut operacional.

5. Përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare

Ky parim i “dyfishimit të kapaciteteve kritike” është praktikë e zakonshme në projektet e sistemit Oracle, dhe rekomandohet nga:

- Oracle Implementation Best Practices (për të patur backup technical resources);*
- Standardet ISO/IEC 20000-1 për menaxhimin e shërbimeve IT, ku kërkohet resilience dhe risk mitigation në burimet njerëzore.*

6. Përfundim

Në përfundim, kërkesa për punonjës të certifikuar:

- është në përpjesëtim me kompleksitetin dhe rëndësinë e objektit të kontratës;*
- nuk synon të kufizojë pjesëmarrjen, por të garantojë cilësi, siguri dhe vazhdimësi shërbimi;*
- siguron që operatori ekonomik të ketë kapacitet real për përballimin e çdo situatë, edhe në rast mungesash apo ngarkesash të papritura.*

*Për të dëshmuar përmbushjen e këtyre kriterëve me siper, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin: Certifikimet që vërtetojnë kualifikimin e personelit **si dhe të provojë disponueshmërinë***

e personelit e vërtetuar kjo me formularet E-siq te listëpagesave aktuale të konfirmuara pranë autoriteteve tatimore.

Kriteret më lartë (nga 2.3.2 a-i), quhen të përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Pra ne shtojcen e publikuar nga AK është ndryshuar numri i personelit nga minimalisht 12 persona në minimalisht 16 persona, duke ruajtur të njëjtat certifikime stafi.

Në DST dhe as në shtojcen e publikuar nga AK në datë 29.10.2025, nuk është përcaktuar në asnjë Rresht që certifikimet duhet të jenë individuale dhe një person nuk duhet të ketë me shumë se një Certifikim. Nuk ka të përcaktuar në DST dhe në ASNJE shtojcë të publikuar nga AK se secili personel i operatorit ekonomik, duhet të mbulojnë vetëm një kategori/certifikim.

Kriteret e kapacitetit teknik (pika 2.3.2) janë vlerësuar në mënyrë të gabuar nga KVO dhe në kundërshtim me DST dhe shtojcen e publikuar nga AK.

Vetë AK ka përcaktuar në DST dhe në shtojcen e publikuar nga AK në datë 29.10.2025 se Kriteret më lartë (nga 2.3.2 a-i), quhen të përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e Formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM - së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin

DATA LOG sh.p.k ka plotësuar dhe nënshkruar formularin e vetëdeklarimit në përputhje të plotë me DST-në dhe shtojcen e publikuar nga AK, dhe ky dokument është i mjaftueshëm dhe i vlefshëm për fazën e ofertimit për kualifikimin e ofertës tone.

KVO ka bërë interpretim të gabuar të funksioneve të personelit dhe kjo mund të vërtetohet lehtësisht.

Në arsyetimin e skualifikimit pretendohet nga KVO se disa punonjës mbulojnë vetëm kategori të caktuara, duke i llogaritur si të papershtatshëm për kërkesa të tjera gjë e cila nuk është përcaktuar në kriteret e vecanta të kualifikimit në DST dhe shtojcen e publikuar nga AK.

DATA LOG sh.p.k ka përmbushur qartësisht dhe pa ASNJE akuivok kriterin 2.3.2 të përcaktuar në DST dhe shtojcen e publikuar nga AK.

Ndryshimi i kriterëve kualifikuese (shtojca e dates 29.10.2025) NUK percakton qe stafi duhet te mbuloje vetem nje kategori dhe nese mbulon nje kategori eshte “i paaftë per te mbuluar kategorine tjeter”.

Me poshte (dorezuar ne SPE gjithashtu) paraqesim formularin tone te vetedeklarimit sipas Shtojces 10, ku dallohet qartesisht se shoqeria jone DATA LOG sh.p.k ka permbushur qartesisht dhe pa ASNJE ekuivok kriterin 2.3.2 te percaktuar ne DST dhe shtojcen e publikuar nga AK, dhe Konkretisht:

Po [X] Jo []

Nese, po, numri i punonjesve:

29 (njetete e nente) punonjes

Profili i punonjesve

2.3.2 Operatori ekonomik pjesemarres, per realizimin e sherbimeve objekt kontrate, duhet te disponoje punonjes te specializuar/te kualifikuar, si me poshte:

a. Punonjes per sistemin e operimit Oracle Linux ose ekuivalent 2 (dy)

ED me certifikim->iOracle Certified Professional Oracle Linux 8 System Administratore,

DC me certifikim->iOracle Certified Professional Oracle Linux 8 System Administratore,

YC, me certifikim->iOracle Linux 6 Solution Engineer Specialiste,

ES, me certifikim->iOracle Linux 6 Solution Engineer Specialiste,

EC, me certifikim->iOracle Linux 6 Solution Engineer Specialiste

b. Punonjes per implementimin e bazave te dhenave Oracle ose ekuivalent 2(dy)

DM, me certifikim->iOracle Database 12c Certified Implementation Specialiste,

VS me certifikim ->iOracle Database 12c Certified Implementation Specialiste

c. Punonjes per administrimin e bazave te dhenave Oracle ose ekuivalent 2(dy)

DM, me certifikim->iOracle Database Administration 2019 Certified Professionale,

ED, me certifikim->iOracle Database Administration 2019 Certified Professionale

d. Punonjes per zhvillim software-i ne Oracle PL/SQL ose ekuivalent 2 (dy)

LM me certifikim->iOracle PL/SQL Developer Certified Associatee,

IP me certifikim->iOracle PL/SQL Developer Certified Associatee,

NS, me certifikim->iOracle Database PL/SQL Developer Certified Professionale,

EA me certifikim->iOracle Database PL/SQL Developer Certified Professionale,

EZ, me certifikim->iOracle Database PL/SQL Developer Certified Professionale

e. Punonjes per zhvillim software-i ne Oracle Forms ose ekuivalent 2 (dy)

LM me certifikim->iOracle Certified Professional, Oracle Fusion Middleëare 11g Forms Developere,

IP me certifikim->iOracle Forms Developer Certified Professionale

f. Punonjes per (General Ledger), (Payables), (Receivables) ose ekuivalent 2(dy)

LV me certifikime->iOracle E-Business Suite 12 Financial Management Certified Implementation Specialist: Oracle General Ledgere, iOracle E-Business Suite 12 Financial Management Certified Implementation Specialist: Oracle Payablese dhe iOracle E-Business Suite 12 Financial Management Certified Implementation Specialist: Oracle Receivablese.

BP me certifikime-> Oracle E-Business Suite 12 Financial Management Certified Implementation Specialist: Oracle General Ledgere, Oracle E-Business Suite 12 Financial Management Certified Implementation Specialist: Oracle Payablese dhe Oracle E-Business Suite 12 Financial Management Certified Implementation Specialist: Oracle Receivablese.

EP me certifikime-> Oracle E-Business Suite 12 Financial Management Certified Implementation Specialist: Oracle General Ledgere, Oracle E-Business Suite 12 Financial Management Certified Implementation Specialist: Oracle Payablese dhe Oracle E-Business Suite 12 Financial Management Certified Implementation Specialist: Oracle Receivablese.

EB me certifikime-> Oracle E-Business Suite 12 Financial Management Certified Implementation Specialist: Oracle General Ledgere, Oracle E-Business Suite 12 Financial Management Certified Implementation Specialist: Oracle Payablese dhe Oracle E-Business Suite 12 Financial Management Certified Implementation Specialist: Oracle Receivablese.

g. Punonjes per te certifikuar per virtualizim ose ekuivalent 2 (dy)

YC me certifikim-> Oracle VM 3.4 for Solution Engineers Assessmente,

ES me certifikim-> Oracle VM 3.4 for Solution Engineers Assessmente

h. Punonjes te Certifikuar si menaxher projekti ose ekuivalente 1(nje)

DM me certifikim-> Project Management Professional (PMP)?e,

ED me certifikim-> Project Management Professional (PMP)?e

i. Punonjes te certifikuar per menaxhimin e sherbimeve IT (ITIL ose ekuivalente) 1(nje)

ED me certifikim-> ITIL? Foundation

Certificate in IT Service Managemente,

DM me certifikim-> ITIL? Foundation

Certificate in IT Service Managemente.

- Personeli i mesiperme duhet te kete aktualisht nje marredhenie pune me ofertuesin jo me pak se 1 (nje) muaj, e vertetuar kjo me formularet E-sig te listepagesave te konfirmuara prane autoriteteve tatimore.

DEKLARATA listepagesa e Kontributeve te Sigurimeve shoqerore, shendetesore dhe Tatimit

Mbi te Ardhetat nga punesimi , Muaji: Shtator

1. ED

2. DC

3. ES

4. VS

5. DM

6. YC

7. LM

8. NS

9. IP

10. BP

11. LV

12. EP

- 13. EC
- 14. EA
- 15. EZ
- 16. EB

Ne pjesen e pare te formularit te vetedeklarimit vihet re numri i punonjesve dhe deklarimet per secilin kriter, ku per secilin kriter numri i punonjesve bashke me certifikatat provon faktin se ne e permbushim kriterin iae pertej asaj afare eshte kerkuar, pra e tejkalojme numrin e punonjesve te kerkuar.

Sa i perket kriterit “b” ashtu sic parashikohet, per implementimin e bazave te dhenave ORACLE kemi dy specialiste te certifikuar.

Sa i perket pikes “c”, sic vertetohet ne formularin e vetedeklarimit te dorezuar nga ofertuesi DATA LOG, shihet se jane dy administrues te bazave te dhenave te cilat kane certifikatat perkatese per kete kriter

Sa i perket kriterit ide, ndonese kerkohen vetem dy punonjes me certifikim PL/SQL ose ekuivalent, ne kemi garantuar 5 te tille, pra e tejkalojme numrin e punonjesve te kerkuar.

Gjithashtu dhe sa i perket pikes “”e dhe kriterit te saj per zhvillim software, kemi paraqitur po ashtu dy punonjes te certifikuar.

Sa i perket pikes “f”, ne arrijme te permbushim po ashtu kete pike ku per kater punonjes zoterohen te gjitha certifikatat e kerkuara nga AK, pra e tejkalojme numrin e punonjesve te kerkuar.

Sa i perket pikes “g” jane po ashtu te konstatuara dhe te garantuara certifikatat e dy punonjesve te stafit per virtualizim.

NE lidhje me piken ihe te kriterëve te veçanta te kualifikimit ne lidhje me menaxherin e projektit kemi paraqitur dy punonjese te certifikuar, pra e tejkalojme numrin e punonjesve te kerkuar.

Sa i perket pikes iie siá provohet dhe ne formularin e vetedeklarimit kemi paraqitur dy punonjes te certifikuar, pra e tejkalojme numrin e punonjesve te kerkuar.[...]

Nga sa me lart, permes formularit te vetedeklarimit paraqesim me fakte qe DATA LOG sh.p.k ka permbushur qartesisisht dhe pa ASNJE akuivok kriterin 2.3.2 te percaktuar ne DST dhe shtojcen e publikuar nga AK

Ndaj shtrojme keto kerkesa per KPP:

KERKESA

Ne baze te argumenteve te mesiperme, DATA LOG sh.p.k kerkon:

- 1. Anulimin e vendimit te skualifikimit te publikuar me date 13.11.2025.*
- 2. Rivleresimin e ofertes sone sipas kriterëve reale te DST-se dhe shtojces te publikuar nga AK ne date 29.10.2025*
- 3. Kualifikimin e ofertes se DATA Log SHPK si nje oferte e hartuar ne perputhje me kriteret e kualifikimit te procedures se prokurimit.”*

II.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 3355/1 Prot., datë 21.11.2025.

II.6. Në datën 02.12.2025, është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 3355/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 11966/11 prot., datë 27.11.2025 me objekt: “ *Dërgohet vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave (në vijim KSHA), mbi shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Data Log” SHPK, për procedurën me objekt ankimi: “Mirëmbajtja për Sistemin Taksave dhe Tarifave Vendore”, bashkëngjitur Vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave “Mbi ankesën e ardhur nga operatori ekonomik “Data Log” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me nr.REF-65750-10-20-2025, me objekt: “Mirëmbajtja për sistemin e taksave dhe tarifave vendore”, me fond limit 4.989.800 lekë, pa TVSH*”. Referuar këtij vendimi rezulton se ankesa e operatorit ekonomik “Data Log” SHPK është refuzuar nga KSHA.

II.7. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020, për prokurimin publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit e dokumentacionit të paraqitur nga ana e autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Data Log” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 9 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 1/a, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

1. *Ofertuesi duhet të paraqesë:*

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*

III.1.2. Në shtojcën 9, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.2. dhe 2.3.3, të dokumenteve të procedurës së mësipërme të prokurimit, të publikuara në SPE, është parashikuar plotësimi i kriterëve si vijon:

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

a. Punonjës për sistemin e operimit Oracle Linux ose ekuivalent 2(dy)

Te pakten 2 (dy) punonjës me certifikim për sistemin e operimit Oracle Linux (ose ekuivalent) në të cilin është instaluar sistemi i menaxhimit financiar. Te deshmohen me certifikatat perkatese.

b. Punonjës për implementimin e bazave të të dhënave Oracle ose ekuivalent 2(dy)

Te pakten 2 (dy) punonjës me certifikim për implementimin e bazave të të dhënave Oracle (ose ekuivalent). Te deshmohen me certifikatat perkatese.

c. Punonjës për administrimin e bazave të të dhënave Oracle ose ekuivalent 2(dy)

Te pakten 2 (dy) punonjës me certifikim për administrimin e bazave të të dhënave Oracle (ose ekuivalent). Te deshmohen me certifikatat perkatese.

d. Punonjës për zhvillim software-i në Oracle PL/SQL ose ekuivalent 2(dy)

Te pakten 2 (dy) punonjës me certifikim për zhvillim software-i në Oracle PL/SQL (ose ekuivalent). Te deshmohen me certifikatat perkatese.

e. Punonjës për zhvillim software-i në Oracle Forms ose ekuivalent 2(dy)

Te pakten 2 (dy) punonjës të certifikuar për zhvillim software-i në Oracle Forms (ose ekuivalent). Te deshmohen me certifikatat perkatese.

f. Punonjës për (General Ledger), (Payables), (Receivables) ose ekuivalent 2 (dy)

Te pakten 2 (dy) punonjës të certifikuar nga Oracle për implementimin e modulit të Librit të Madh (General Ledger) ose ekuivalent, të Pagueshme (Payables) ose ekuivalent, të Arketueshme (Receivables) ose ekuivalent. Te deshmohen me certifikatat perkatese.

g. Punonjës për të certifikuar për virtualizim ose ekuivalent 2 (dy)

Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar për virtualizim ose ekuivalent;

h. Punonjës të të certifikuar si menaxher projekti ose ekuivalente 1 (një)

Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si menaxher projekti ose ekuivalente.

i. Punonjës të certifikuar për menaxhimin e shërbimeve IT (ITIL ose ekuivalente) 1 (një)

Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhimin e shërbimeve IT (ITIL ose ekuivalente).

Arsyetim teknik për kërkesën e punonjësve të certifikuar:

Në hartimin e pikës 2.3.2 “Kapaciteti teknik dhe profesional” është parashikuar që operatori ekonomik pjesëmarrës të disponojë në total 16 punonjës të certifikuar, të ndarë sipas fushave specifike të shërbimeve Oracle dhe teknologjive mbështetëse. Ky kriter është vendosur jo për të

kufizuar konkurrencën, por për të garantuar cilësinë, qëndrueshmërinë dhe sigurinë e zbatimit të projektit gjatë gjithë ciklit të jetës së kontratës.

1. Sigurimi i vazhdimësisë së shërbimit

Objekti i kontratës përfshin shërbime të ndërlikuara që lidhen me:

- Sisteme operative Oracle Linux (ose ekuivalente);*
- Baza të të dhënave Oracle;*
- Zhvillime software në PL/SQL dhe Oracle Forms;*
- Implementim të moduleve financiare si General Ledger, Payables, Receivables;*
- Virtualizim dhe administrim IT.*

Për këtë arsye, u vlerësua se për çdo kategori të shërbimit duhet të ketë minimalisht dy persona të certifikuar:

- në mënyrë që të sigurohet zëvendësueshmëri në rast sëmundjeje, leje, dorëheqje apo ngarkese të lartë pune;*
- për të shmangur varësinë nga një individ i vetëm në një fushë kritike për funksionimin e sistemit financiar.*

Kjo politikë ndjek parimin back-up njerezor, e cila është praktikë standarde në projektet e teknologjisë së informacionit që kanë ndikim direkt në procese financiare dhe institucionale.

2. Siguri në ruajtjen e njohurive institucionale.

Projekti ka në thelb sisteme Oracle që kërkojnë njohuri shumë të specializuara dhe të fituara përmes certifikimeve ndërkombëtare. Nëse operatori ekonomik do të kishte vetëm një punonjës të certifikuar për secilën fushë, ekziston rreziku që, në rast largimi apo mungese të tij, njohuritë kritike humbasin dhe projekti mbetet i bllokuar.

Prandaj kërkesa për dy persona të certifikuar për çdo fushë siguron që njohuritë dhe përgjegjësitë të ndahen, të dokumentohen dhe të jenë gjithmonë të transferueshme brenda ekipit.

3. Nevoja për punë paralele dhe faza kritike

Në fazat e implementimit dhe mirëmbajtjes, shpesh është e nevojshme që disa detyra të kryhen njëkohësisht, si:

- konfigurimi i serverëve dhe testimi i bazës së të dhënave;*
- zhvillimi i moduleve PL/SQL ndërkohë që bëhen rregullime në Oracle Forms;*
- implementimi i moduleve financiare në disa njësi njëkohësisht.*

Në këto raste, vetëm një person i certifikuar për çdo fushë do të krijonte vonesa, ngarkesë të tepërt dhe rrezik operativ. Dy persona për çdo fushë lejojnë ndarjen e punës dhe garantojnë përfundimin në afatet kontraktuale.

4. Rrjedhojat në mungesë të stafit të dyfishtë

Nëse projekti do të mbështetej vetëm te një individ për secilën teknologji, çdo mungesë apo problem personal i tij do të shkaktonte:

- ndërprerje të menjëhershme të shërbimit teknik;*
- pamundësi për të reaguar në kohë ndaj incidenteve;*

- vonesa në zbatim dhe rrezik penaltetesh për operatorin dhe autoritetin kontraktor.

Duke kërkuar minimalisht dy persona të kualifikuar për çdo komponent, sigurohet vazhdimësi e shërbimit 24/7 dhe reduktim i riskut operacional.

5. Përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare

Ky parim i “dyfishimit të kapaciteteve kritike” është praktikë e zakonshme në projektet e sistemit Oracle, dhe rekomandohet nga:

- Oracle Implementation Best Practices (për të patur backup technical resources);
- Standardet ISO/IEC 20000-1 për menaxhimin e shërbimeve IT, ku kërkohet resilience dhe risk mitigation në burimet njerëzore.

6. Përfundim

Në përfundim, kërkesa për punonjës të certifikuar:

- është në përpjesëtim me kompleksitetin dhe rëndësinë e objektit të kontratës;
- nuk synon të kufizojë pjesëmarrjen, por të garantojë cilësi, siguri dhe vazhdimësi shërbimi;
- siguron që operatori ekonomik të ketë kapacitet real për përballimin e çdo situatë, edhe në rast mungesash apo ngarkesash të papritura.

Për të dëshmuar përmbushjen e ketyre kriterëve me sipër, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin: **Certifikimet që vërtetojnë kualifikimin e personelit *si dhe të provojë disponueshmërinë e personelit e vërtetuar kjo me formularet E-siq te listëpagesave aktuale të konfirmuara pranë autoriteteve tatimore.***

Kriteret më lartë (nga 2.3.2 a-i), quhen të përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë personel prej minimalisht 16 personave. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Kjo kërkesë është parashikuar që operatori ekonomik pjesëmarrës të disponojë në total 16 punonjës të certifikuar, të ndarë sipas fushave specifike të shërbimeve Oracle dhe teknologjive mbështetëse. Ky kriter është vendosur jo për të kufizuar konkurrencën, por për të garantuar cilësinë, qëndrueshmërinë dhe sigurinë e zbatimit të projektit gjatë gjithë ciklit të jetës së kontratës.

III.1.2. Në shtojcën 10 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

Shtojca 9

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	<u>Punonjës</u> Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: Profili i punonjësve <u>Makineri e mjete</u> Po [] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:
Emri, Mbiemri _____ Firma _____ Vula _____	

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.
- Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.
- Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraparak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.
- Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

III.1.3. Nga verifikimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik "Data Log" SHPK, në përmbushje të kriterëve sa më sipër cituar, ka dorëzuar Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 10), të plotësuar prej tij, ku në Deklaratën për disponimin e punonjësve, është deklaruar si vijon:

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:	<u>Punonjës</u>

Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	Po [X] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: 29 (njëzetë e nëntë) punonjës Profili i punonjësve 2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë: a. Punonjës për sistemin e operimit Oracle Linux ose ekuivalent 2 (dy) <i>E. ... D. ... me certifikim->"Oracle Certified Professional Oracle Linux 8 System Administrator",</i> <i>D. ... C. ... me certifikim->"Oracle Certified Professional Oracle Linux 8 System Administrator",</i> <i>Y. ... Ç. ... me certifikim->"Oracle Linux 6 Solution Engineer Specialist",</i> <i>E. ... S. ... me certifikim->"Oracle Linux 6 Solution Engineer Specialist",</i> <i>E. ... C. ... me certifikim->"Oracle Linux 6 Solution Engineer Specialist"</i> b. Punonjës për implementimin e bazave të të dhënave Oracle ose ekuivalent 2(dy) <i>D. ... M. ... me certifikim->"Oracle Database 12c Certified Implementation Specialist",</i> <i>V. ... S. ... me certifikim->"Oracle Database 12c Certified Implementation Specialist"</i> c. Punonjës për administrimin e bazave të të dhënave Oracle ose ekuivalent 2(dy) <i>D. ... M. ... me certifikim->"Oracle Database Administration 2019 Certified Professional",</i> <i>E. ... D. ... me certifikim->"Oracle Database Administration 2019 Certified Professional"</i> d. Punonjës për zhvillim software-i në Oracle PL/SQL ose ekuivalent 2 (dy)
---	---

	<i>Etikimi Përfundim me certifikime->"Oracle E-Business Suite 12 Financial Management Certified Implementation Specialist: Oracle General Ledger", Oracle E-Business Suite 12 Financial Management Certified Implementation Specialist: Oracle Payables" dhe "Oracle E-Business Suite 12 Financial Management Certified Implementation Specialist: Oracle Receivables".</i> <i>Etikimi Baza me certifikime->"Oracle E-Business Suite 12 Financial Management Certified Implementation Specialist: Oracle General Ledger", Oracle E-Business Suite 12 Financial Management Certified Implementation Specialist: Oracle Payables" dhe "Oracle E-Business Suite 12 Financial Management Certified Implementation Specialist: Oracle Receivables".</i> g. Punonjës për të certifikuar për virtualizim ose ekuivalent 2 (dy) <i>Etikimi Çështje me certifikim->"Oracle VM 3.4 for Solution Engineers Assessment",</i> <i>Etikimi Shtet me certifikim->"Oracle VM 3.4 for Solution Engineers Assessment"</i> h. Punonjës të të certifikuar si menaxher projekti ose ekuivalente 1(nje) <i>Etikimi Mësim me certifikim->"Project Management Professional (PMP)®",</i> <i>Etikimi Dëshm me certifikim->"Project Management Professional (PMP)®"</i> i. Punonjës të certifikuar për menaxhimin e shërbimeve IT (ITIL ose ekuivalente) 1(nje) <i>Etikimi Dëshm me certifikim->"ITIL® Foundation Certificate in IT Service Management",</i> <i>Etikimi Mësim me certifikim->"ITIL® Foundation Certificate in IT Service Management".</i>
--	---

	<i>Le...n M... me certifikim->"Oracle PL/SQL Developer Certified Associate",</i> <i>Ir... P... me certifikim->"Oracle PL/SQL Developer Certified Associate",</i> <i>Ne... S... me certifikim->"Oracle Database PL/SQL Developer Certified Professional",</i> <i>Er... Ar... si me certifikim->"Oracle Database PL/SQL Developer Certified Professional",</i> <i>Er... Z... me certifikim->"Oracle Database PL/SQL Developer Certified Professional"</i> e. Punonjës për zhvillim software-i ne Oracle Forms ose ekuivalent 2 (dy) <i>Le...n M... me certifikim->"Oracle Certified Professional, Oracle Fusion Middleware 11g Forms Developer",</i> <i>Ir... P... me certifikim->"Oracle Forms Developer Certified Professional"</i> f. Punonjës për (General Ledger), (Payables), (Receivables) ose ekuivalent 2(dy) <i>Li... V... me certifikime->"Oracle E-Business Suite 12 Financial Management Certified Implementation Specialist: Oracle General Ledger", "Oracle E-Business Suite 12 Financial Management Certified Implementation Specialist: Oracle Payables" dhe "Oracle E-Business Suite 12 Financial Management Certified Implementation Specialist: Oracle Receivables".</i> <i>Bl... P... me certifikime->"Oracle E-Business Suite 12 Financial Management Certified Implementation Specialist: Oracle General Ledger", "Oracle E-Business Suite 12 Financial Management Certified Implementation Specialist: Oracle Payables" dhe "Oracle E-Business Suite 12 Financial Management Certified Implementation Specialist: Oracle Receivables".</i>
--	--

<i>Leximi i Muajit me certifikim->"Oracle PL/SQL"</i> - Personeli i mësipërm duhet të ketë aktualisht një marrëdhënie pune me ofertuesin jo me pak se 1 (një) muaj, e vërtetuar kjo me formularet E-sig te listëpagesave të konfirmuara pranë autoriteteve tatimore. DEKLARATA "Listëpagesa e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi", Muaji: Shtator 1. Efiti Dile... 2. Dileti Ç... 3. Efiti S... 4. Viti S... 5. Dileti M... 6. Ylli Ç... 7. Leximi M... 8. N... 9. Ir... 10. B... 11. L... 12. E... 13. E... 14. E... 15. E... 16. E... <u>Makineri e mjete</u> Po [] Jo [X] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:	
Emri, Mbiemri Y Firma Vula Data e dorëzimit të deklaratës 07.11.2025	
<i>Specialist: Oracle Receivables".</i>	

III.1.4. Në nenin 77, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.1.5. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake** në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, **formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji.** Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

III.1.6. Ndërsa në nenin 92/3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.1.7. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.**

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin,

si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohej për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rruqë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

III.1.8. Në nenin 39, pika 4 dhe gërma “c” dhe “ç” e pikës 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se: “4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose
- ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.[...]”

III.1.9. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Në pikën 1 dhe 6 të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.** 2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon: i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; 6. **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE, Komisioni konstaton, se operatori ekonomik Data Log” SHPK ka dorëzuar Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit ku rezulton, se nga ana e tij janë plotësuar të gjitha të dhënat e mundshme që parashikon ky formular, specifikisht ka deklaruar personelin dhe stafin teknik sipas përcaktimeve të parashikuara në kriteret e veçanta të kualifikimit si më sipër cituar. Konkretisht nga ana e autoritetit kontraktor në pikën 2.3.2 dhe 2.3.3. të kriterëve të veçanta të kualifikimit është kërkuar që operatori ekonomik të disponojë me certifikata përkatëse të pakten 2 (dy) punonjës me certifikim për sistemin e operimit Oracle Linux (ose ekuivalent), 2 (dy) punonjës me certifikim për implementimin e bazave të të dhënave Oracle

(ose ekuivalent) ; 2 (dy) punonjës me certifikim per administrimin e bazave të të dhënave Oracle (ose ekuivalent), 2 (dy) punonjës me certifikim per zhvillim software-i ne Oracle PL/SQL (ose ekuivalent) ; 2 (dy) punonjës te certifikuar per zhvillim software-i ne Oracle Forms (ose ekuivalent) ; 2 (dy) punonjës te certifikuar nga Oracle per implementimin e modulit e Librit te Madh (General Ledger) ose ekuivalent, te Pagueshmeve (Payables) ose ekuivalent, te Arketueshmeve (Receivables) ose ekuivalent; 2 (dy) punonjës të certifikuar për virtualizim ose ekuivalent; 1 (një) punonjës të certifikuar si menaxher projekti ose ekuivalente; 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhimin e shërbimeve IT (ITIL ose ekuivalente).

Gjithashtu në pikën 2.3.4 të kriterëve kualifikuesë është kërkuar që ofertuesi të disponojë personel minimalisht 16 persona.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Nga shqyrtimi i Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, të shoqërisë ankimese, rezulton se nga e tij është deklaruar se: “ Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor” dhe në vijim nga ana e tij janë deklaruar emrat përkatës të punonjësve të specializuar/të kualifikuar për të paktën 2 (dy) punonjës me certifikim per sistemin e operimit Oracle Linux (ose ekuivalent) 2 (dy) punonjës me certifikim per implementimin e bazave të të dhënave Oracle (ose ekuivalent), 2 (dy) punonjës me certifikim per administrimin e bazave të të dhënave Oracle (ose ekuivalent), 2 (dy) punonjës me certifikim per zhvillim software-i ne Oracle PL/SQL (ose ekuivalent), 2 (dy) punonjës te certifikuar per zhvillim software-i ne Oracle Forms (ose ekuivalent), 2 (dy) punonjës te certifikuar nga Oracle per implementimin e modulit e Librit te Madh (General Ledger) ose ekuivalent, te Pagueshmeve (Payables) ose ekuivalent, te Arketueshmeve (Receivables) ose ekuivalent 2 (dy) punonjës të certifikuar për virtualizim ose ekuivalent; 1 (një) punonjës të certifikuar si menaxher projekti ose ekuivalente, 1 (një) Punonjës të certifikuar për menaxhimin e shërbimeve IT (ITIL ose ekuivalente). Gjithashtu janë deklaruar edhe emrat e 16 personave, të cilat përputhen me emrat e personelit të deklaruar si më sipër.

Rezulton se autoriteti kontraktor gjatë vlerësimit për këtë procedurë prokurimi dhe përpara publikimit të njoftim-fituesit, nuk ka zbatuar përcaktimet e bëra në pikën 6 të nenit 26 të VKM, ku thuhet se **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.** Gjithashtu nuk ka kërkuar asnjë sqarim apo informacion në përputhje me pikën 7 të nenit 26 të VKM, sipas së cilës në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e

informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose t'i kërkojë sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Në rastin konkret autoriteti kontraktor nuk i ka kërkuar ofertuesit dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në pikën 2 shkronjën h) *operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti); shkronjën i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti, për arritjen e një përfundimi të saktë, që operatori ekonomik ankimes nuk i plotëson këto kriterë.*

Gjithashtu, sipas shtojcës 8 Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, Pjesa II, Pika A-Deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, është përcaktuar që referencat për këto lloj deklarata do të bëhen në rastet kur janë të zbatueshme: “Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni”. Pra, Komisioni gjykon, se ka dy mënyra se si autoriteti kontraktor mund të marrë këto dokumente, e para në bazë të të dhënave të aksesueshme shtetërore nëse është i disponueshëm dhe e dyta **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM-së, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.**

Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor në fazën e vlerësimit procedural në të cilën ndodhet aktualisht procedura e prokurimit objekt-ankimi, për përmbushjen e kriterëve të kualifikimit, duhet t'i referohet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas rubrikave të aksesueshme elektronikisht nga autoriteti kontraktor dhe kërkesën për **dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM-së, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.**

Akoma më tej, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti/enti kontraktor ai që duhet t'i kërkojë **ofertuesit të kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM-së 285.** Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin, për t'u siguruar nëse cilësia e shërbimit, punës apo mallit është e njëjtë me cilësinë e premtuar në momentin apo fazën e ofertimit. Në këto kushte, Komisioni gjykon, se skualifikimi i operatorit ekonomik ankimes nga ana e autoritetit kontraktor nuk është i drejtë.

Për sa më lart, pretendimet e ankimesit qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Data Log” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me nr. REF-65750-10-20-2025, me objekt: “Mirëmbajtja për Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore”, me fond limit 4.989.800 lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 07.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Data Log” SHPK si dhe të korrigjojë shkeljet, duke e kualifikuar këtë operator.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Data Log” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro

